



06-04-2023

Prishtinë / Priština

Nr/Pr. 22-375-2023



Në mbështetje të nenit 66.5 të Ligjit nr. 03/L-073, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, bazuar në Konkursin KQZ-16/2023, të publikuar më datën 08.02.2023, për pozitën Zyrtar i Lartë për Financa (Zotues), Kryeshefi Ekzekutiv i SKQZ-së, më datë 06.04.2023, nxjerr këtë:

VENDIM

Për Anulimin e Konkursit për Pozitën Zyrtar i Lartë për Financa (Zotues) me Numër Reference KQZ-16/2023

- I. Anulohet Konkursi për pozitën Zyrtar i Lartë për Financa (Zotues), me numër reference KQZ-16/2023.
- II. Obligohet Departamenti i Administratës dhe Përkrahjes - Divizioni për Personel për zbatimin e këtij vendimi.
- III. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Sekretariati i KQZ më datën 24.02.2023 deri më 13.03.2023, ka publikuar konkursin me numër reference KQZ-16/2023, për pozitën Zyrtar i Lartë për Financa (Zotues).

Kryeshefi Ekzekutiv më datën 10.03.2023 ka nxjerrë vendimin Nr.02/283/2023, për formimin e Komisionit përzgjedh për pozitën Zyrtar i Lartë për Financa (Zotues).

Komisioni përzgjedhës më datën 23.03.2023, ka shqyrtuar aplikacionet e aplikuesëve, ndërsa raporti me shkrim për pozitën në fjalë është bërë më datën 27.03.2023, nga kryesuesi i komisionit

Komisioni përzgjedhur më datën 29.03.2023, ka mbajtur testin me shkrim, ndërsa më datën 30.03.2023 komisioni ka bërë vlerësimin e testeve me shkrim.

Kryesuesja e komisionit, me datën 04.04.2023, ka përgatitur raportin e procesit deri në këtë fazë të procesit rekrutues.

Dy anëtarët e komisionit përzgjedhës z.Nexhmedin Hyseni dhe z.Vuksan Vuksanovic, në shenjë pakënaqësie dhe mos pajtimeve brenda komisionit, lidhur me këtë proces të vlerësimit, më datën 05.04.2023, kanë dhënë dorëheqje nga ky proces i rekrutimit, me arsyetimin se mënyra e përgatitjes së testit me shkrim pjesa e përgjithshme dhe pjesa profesionale nuk janë në përputhje me Rregulloren Nr.03/2017-procedurat e rekrutimit, emërimit dhe punës provuese të nëpunësve në SKQZ, përkatësisht nenin 27 paragrafi 2.1 dhe 2.2.

Andaj, bazuar në dorëheqjen e dy anëtarëve të komisionit rekrutues, paraqet problem serioz në vlerësimin dhe përzgjedhje meritore bazuar në parimin e shanseve të barabarta, mos diskriminimit dhe përfaqësimit të barabartë, meritës, transparencës, profesionalizmit, paanshmërisë. Meqenëse, procesi deri në këtë fazë ka humbur kredibilitetin, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prishtinë, 06.04.2023

Burim Ahmetaj


Kryeshf Ekzekutiv i SKQZ-së



Ky vendim i dorëzohet:

DAP-it,

Divizionit për Personel,

Arkivit

